

Republika e Shqipërisë  
Dhoma e Noterisë Tiranë  
Majlinda E. Demollari

Nr 170 Rep

Nr \_\_\_\_\_ Kol

177

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË  
“NATYRAL INVEST” SHPK**

*Majlinda E. Demollari*  
*Taksa e Përdorimit*  
*U Përqura*



Në Tiranë, sot me datë 9/01/2018, para meje Noterit Publik Majlinda E. Demollari, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqit personalisht ortakut i vetëm Artur Dojaka, i biri i Harun, i lindur në Tiranë, më 06/06/1970, banues në Rr. “Qemal Stafa” Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar përmes kartës së identitetit me Nr.025168504, i cili me vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare” dhe legjislacionin tjetër në fuqi, vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “NATYRAL INVEST” SHPK, në bazë të kushteve që vijojnë:

**THEMELIMI**

**Neni 1  
Ortak themelues**

1.1 Shoqëria “NATYRAL INVEST” sh.p.k. themelohet nga ortakut i vetëm Artur Dojaka, i biri i Harun, i lindur në Tiranë, më 06/06/1970, banues në Rr. “Qemal Stafa”, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar përmes kartës së identitetit me Nr.025168504.

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**Neni 2  
Emërtimi**

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “NATYRAL INVEST” sh.p.k.

**Neni 3  
Forma ligjore**

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4  
Baza ligjore**

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.



**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendren Kombëtare të Biznesit (“QKB”).

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

**Neni 6**  
**Selia**

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: **Rr. “Pjetër Bogdani”, Pallati 13/1, Tiranë**.

6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri.

**Neni 7**  
**Emblema dhe Vula**

7.1 Pas rregjistrimit të shoqërisë në QKB, shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratori i shoqërisë.

7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj.

**Neni 8**  
**Objekti**

8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

*Themelimi dhe krijimi i Shoqërive dhe Sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja si dhe pjesmarrja në to, administrimi dhe drejtimi i shoqërive tregtare dhe sipërmarrjeve; blerja apo disponimi me pjesmarrje në kapital në korporata, partneritete apo shoqëri me objekte aktiviteti të ndryshme; blerja e shitja e aksioneve dhe kuotave apo pjesmarrjeve të tjera në sipërmarrje dhe shoqëri, brenda kufijve të lejuar nga legjislacioni shqiptar; blerja, barrësimi, hipotekimi apo transferimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme apo titujve të tjerë. Pjesmarrje në shoqëri me objekte aktiviteti në fushën e ndërtimit, agroturizëm, investime në energjitikë, imobiliare, tregti me shumicë e pakicë, transport, prodhim dhe përpunim, import-export etj. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë dhe të realizojë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, apo ka të bëjë me objektivat e renditura më sipër. Për të arritur qëllimin e mësipërm Shoqëria mund të ndër marrë veprime me pasuri të luajtshme apo të paluajtshme dhe çdo aktivitet tregtar apo financiar, për dhënie me qira apo hipotekim që mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme në mënyrë që të arrihet objektivi i Shoqërisë. Përveç veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë çdo veprimtari që do të konsiderohet nga ortakët si e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin Shqiptar.*

8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.



## **Neni 9 Kapitali**

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë (njëqindlekë).
- 9.2 Kapitali përbëhet nga një kuotë e vetme që përbën 100 (njëqind) përqind të kapitalit, me vlerë nominale 100 (njëqind) lekë.
- 9.3 Pjesët e kapitalit zotërohen në masën e plotë 100% nga ortaku i vetëm. Ortaku mund të shesë pjesërisht kuotat e shoqërisë duke futur në ortakëri edhe subjekte të tjerë në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi.
- 9.4 Kapitali është shlyer tërësisht nga ortaku themelues përmes pagesës në bankë.

## **Neni 10 Transferimi i pjesëve të kapitalit, kufizimet**

- 10.1 Pjesët e kapitalit mund të transferohen nga ortaku zotërues i tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 10.2 Vendosja e çfarëdo lloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblese së Ortakëve.

## **Neni 11 Rritja e kapitalit**

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese së Ortakëve.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Ortakëve.

## **Neni 12 Zvogëlimi i kapitalit**

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit, të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Ortakëve. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblesë se Ortakëve raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.

## **ORGANET E SHOQËRISË**

## **Neni 13 Vendimet e Asamblese se ortakeve**





13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Asambleja e Ortakëve të saj.

13.2 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve përfshijnë kryesisht:

- § ndryshimin e selisë dhe të emërimit të shoqërisë;
- § emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
- § rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- § shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- § prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- § emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- § miratimin e bilancit të shoqërisë;
- § ndryshimin e statutit të shoqërisë;
- § transformimin e shoqërisë në forma të tjera.
- § dhe çdo lëndë tjetër të përcaktuar nga neni 81 i Ligjit Nr. 9901/2008.

#### **Neni 14 Administrimi**

14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose nga nje grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblesë se Ortakëve.

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe te drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblesë se Ortakëve. Administratori mund të delegojë kompetenca tek persona të tretë ose punonjës sipas autorizimeve të shkruara.

14.3 Administratori i shoqërisë do të jetë Klodian Shatraj, lindur më 26/02/1981, i biri i Llade, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar përmes kartës së identitetit me Nr.029426317.

14.4 Administratori zotëron të drejta të plota dhe e ushtron funksionin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rast se ka më shumë se një administrator, secili prej tyre, ose personat e autorizuar prej tyre, mund të kryejë në mënyrë të pavarur veprime me bankat dhe çdo instutucion tjetër.

14.5 Administratorët janë përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- § drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
- § përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
- § hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
- § përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zotëron;





§ të lidhë kontrata për dhe në emër të shoqërisë me palë të treta, të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë;

§ të përfaqësojë shoqërinë përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryejë çdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;

§ të ndërmarrë cdo veprimtari tjetër, ose biznes, ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për biznesin e shoqërisë në Shqipëri.

14.6 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në castin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Ortakëve.

### **Neni 15** **Viti financiar**

15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe perfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

### **Neni 16** **Bilanci. Kontabiliteti**

16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit.

16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhen dhe monedhen shqiptare si dhe sipas kerkesave te legjislacionit perkatës. Për operacione të vecanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të vecanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### **Neni 17** **Te ardhurat, dividendi**

17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezerve per realizimin e qellimeve të biznesit të saj në perputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e vitit ushtrimor të parë deri në tre vitet ushtrimorë vijues.



## Neni 18 Likuidimi

18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kuotave të Shoqërisë.

18.2 Me vendimin e Asamblesë së Ortakëve caktohet një likuidues ose një grup likuiduesish që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.

18.3 Likuiduesi do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Ortakëve do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

18.4 Për likuidimin e shoqërisë mund të aplikohet edhe likuidimi i thjeshtëzuar në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

## Neni 19 Mosmarrëveshjet

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## Neni 20 Klauzolë mbyllëse


20.1 Ky Statut hartohet në 5 (pese) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë, më 15/01/2018

**ORTAKU THEMELUES**

**Artur Dojaka**

*Artur Dojaka*  
*AD*



NOTERE  
Mafinda E. Demollari  
NRDP: K41606040A  
Tel: 0682061560